

PLATFORMË POLITIKASH NGA TË RINJTË E KOMUNËS SË GJILANIT

KORRIK - SHTATOR 2017



COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 34,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Ambasadës Britanike në Prishtinë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PROPOZIM-PLATFORMË POLITIKASH PËR KANDIDATË PËR KRYETAR KOMUNE NË GJILAN ME QËLLIM TË ADRESIMIT TË ÇËSHTJEVE TË IDENTIFIKUARA SI PRIORITETE NGA GRUPI JOFORMAL I TË RINJVE

KORRIK - SHTATOR 2017





PËRMBLEDHJE

Konsolidimi dhe avancimi i qeverisjes së mirë, përveç tjerash kërkon pjesëmarrje aktive të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave publike si dhe kërkim llogaridhënies nga politikanët. Pavarësisht mundësive dhe hapësirës që ofron korniza ligjore për pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e bërjes së politikave, sidomos atyre në nivelin komunal, përvoja e deritashme ka dëshmuar që pjesëmarrja mbetet shumë e vogël dhe e kufizuar kryesisht në dy takimet e obligueshme që organizohen brenda vitit me qytetarë. Kjo pjesëmarrje reduktohet edhe më shumë kur bëhet fjalë për të rinjtë, të cilët marrin pjesë në nivele pothuajse të papërfillshme të procesit të bërjes së politikave publike, e në veçanti të politikave që kanë implikime direkte në jetët e tyre.

Marrë parasysh këtë pjesëmarrje kaq të ulët të të rinjve në proceset vendimmarrëse, dhe me qëllim të nxitjes së të rinjve për pjesëmarrje aktive në proces dhe ngritjes së nivelit të përgjegjësisë nga ana e politikanëve, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është duke zbatuar projektin **“Fuqizimi i votueseve të rinjve për të marrë vendime duke qenë të informuar, dhe duke i ndihmuar**

ata që t’i mbajnë politikanët llogaridhënës.” Fillimisht, në kuadër të këtij projekti është zhvilluar një hulumtim i opinionit publik me të rinj të moshave 17 deri 21 vjeç. Të gjeturat kryesore të këtij hulumtimi tregojnë një shpërputhje mes temave të servuara në baza të politikës ditore, dhe temave që realisht preokupojnë të rinjtë. Shqetësimet kryesore të të rinjve konsistojnë në mungesën e perspektivës së punësimit, zhvillimit ekonomik, nivelin e lartë të korrupsionit, gjendjen në sektorin e shëndetësisë dhe liberalizimin e vizave. Kurse, sa i përket institucioneve më të besueshme për të rinjtë, komuna cilësohet si institucioni më i besueshëm dhe vendi i parë ku të rinjtë tentojnë të adresojnë problemet e tyre.

Mungesa e komunikimit me politikanë apo zyrtarë të partive politike është element tjetër që reflektohet në të gjeturat e hulumtimit të opinionit publik. Më konkretisht, rezultatet tregojnë se 80% e të rinjve nuk kanë komunikuar dhe nuk kanë marrë pjesë **asnjëherë** në debate me politikanë apo zyrtarë të partive politike.





Më tutje, në funksion të përmirësimit të nivelit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendim-marrëse dhe rritjen e nivelit të përgjegjësisë së politikanëve, KDI ka mbajtur fillimisht shtatë (7) punëtori dy-ditore dhe katër (4) debate publike mes të rinjve dhe të zgjedhurve të tyre. Gjatë punëtorisë për llogaridhënie, rreth 200 pjesëmarrës të rinj u trajnuan lidhur me format moderne të kërkim llogaridhënies, vënien në funksion të vlerave në politikë, sistemet zgjedhore dhe të tjera.

Gjatë debateve publike, është vërejtur se shumica e shqetësimeve të të rinjve janë adresuar për nivelin lokal të qeverisjes. Për këtë arsye, por edhe me qëllim të shtrirjes së kërkim llogaridhënies edhe në nivelin lokal, KDI ka vazhduar me organizimin e punëtorive për politikën e të rinjve, që si synim parësor kanë identifikimin, priorizimin dhe ofrimin e alternativave për problemet e të rinjve. Gjatë muajve qershor dhe korrik, janë mbajtur gjithsej shtatë (7) punëtori, në komunat më të mëdha të vendit: Prishtinë, Gjilan, Prizren, Mitrovicë, Pejë, Ferizaj dhe Gjakovë.


Grupet e të rinjve të përbërë nga studentë, ndërmar-rës të rinj, përfaqësues të grupimeve rinore të partive politike në nivel lokal, gjatë punëtorive në fjalë kanë identifikuar disa çështje apo probleme që janë të nda-ra në pesë fusha (sektorë) që bien në kompetencë të komunës. Po ashtu, janë ofruar edhe propozime për masat dhe mënyrat si do të mund të adresoheshin nga ana e autoriteteve komunale. Këto probleme dhe ofrimi i masave për zgjidhjen e tyre janë përfshirë në këtë dokument që do të ndahet edhe në formë të platformave politike për kandidatët e mundshëm për kryetar komune në zgjedhjet lokale që do të mbahen në tetor 2017, në secilën nga komunat ku janë mbajtur punëtoritë.



PROCESI I BËRJES SË POLITIKAVE NË NIVELIN LOKAL

Bazuar në ligjet e aplikueshme (Ligji për Vetëqeverisje lokale), procesi i bërjes së politikave në nivelin komunal është përgjegjësi e Kryetarit të Komunës (ekzekutivi) dhe Asamblesë Komunale (legjislativi). Në praktikë, pjesa më e madhe e këtij procesi inicohet dhe derivohehet nga ekzekutivi, derisa Asambleja rëndom përfshihet në proces të miratimit të politikave (vendime, rregullore) që sillen nga ekzekutivi. Përkundër faktit që me ligjet e aplikueshme komunat janë të pajisura me gamë të gjerë të kompetencave, është evidente që në shumë raste ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm për zbatim të projekteve të planifikuara dhe ofrim të shërbimeve të mira për qytetarët. Për pasojë, autoritetet komunale janë 'të detyruara' shumë herë të prioritojnë dhe zgjedhin çështjet dhe projektet që duhen zbatuar më parë.

Duke pasur parasysh kufizimet buxhetore si dhe problemet që ballafaqojnë komunat në procesin e hartimit të buxheteve komunale, diskutimi dhe puna e grupeve të rinjve është orientuar në identifikimin e çështjeve që janë të prekshme, të zbatueshme dhe që në pjesën më të madhe nuk kanë implikime të mëdha buxhetore. Çështjet e prioritetuara dhe të propozuara në këtë dokument nuk paraqesin një listë me dëshira.





OBJEKTIVAT

JANË DY OBJEKTIVA QË SYNOHEN
TË ARRIHEN:

1

Përfshirja e drejtpërdrejtë e të rinjve në procesin e bërjes së politikave publike duke ofruar propozime konkrete për çështjet që kërkojnë zgjidhje. Përfshirja ose jo e këtyre propozimeve nga ana e kandidatëve për kryetar komune në programet e tyre do t'iu shërbej të rinjve si mjet vlerësimi në marrjen e vendimeve të drejta.

2

Intensifikimi i komunikimit ndërmjet kandidatëve të mundshëm për zgjedhje komunale dhe qytetarëve, respektivisht të rinjve në identifikimin e problemeve dhe që diskutimet e përbashkëta me pjesëmarrje aktive qytetare të rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve, respektivisht të rinjve.

Prioritetet e identifikuarra janë:

1

SEKTORI I ARSIMIT:



Problemet e identifikuarra:

Identifikimi i problemeve shëndetësore tek fëmijët në kohë të hershme, të cilat jo rrallë rezultojnë me pasoja më të mëdha konsiderohet si problem i madh që duhet të adresohet me prioritet. Çmimet e shërbimeve që ofrohen në kampusin e shkollave të mesme është identifikuar si një problem tjetër nga ana e grupit të të rinjve. Përveç çështjes së çmimeve, pjesa e dytë e problemit lidhet me nevojën për sqarim të opinionit pse shërbimet e ofruara brenda kampusit ofrohen vetëm nga një kompani e vetme? Transporti i fëmijëve në shkolla paraqet një problem të madh për shumë prindër. Problem tjetër parqet edhe perceptimi se shkollat në fshatra nuk marrin vëmendjen e njëjtë nga ana e autoriteteve komunale dhe se

ato neglizhohen! Regjistrimi i nxënësve në shkolla larg vendbanimeve ku jetojnë është një dukuri që është mjaft e evidente dhe si e tillë paraqet një problem që kërkon të adresohet. Jo rrallë, nxënësit regjistrohen në shkolla që janë më larg vendbanimeve të tyre dhe jo në shkolla që ndodhen më afër. Të rinjtë përballen edhe me mungesë të hapësirës dhe kushteve adekuate për lexim. Prania e universiteteve publike dhe private në komunë ka shtuar numrin e të rinjve që studiojnë dhe rrjedhimisht kanë nevojë për hapësirë ku mund të lexojnë; Këtu duhet të konsiderohet edhe problemi që shumë të rinj mund të kenë me çmimin e caktuar për lexim në bibliotekë.

Masat e propozuara – politika të nevojshme për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale duhet me prioritet të sjellin dhe implementojnë vendimin për kontroll shëndetësor sistematik të nxënësve nëpër shkolla nga niveli parashkollor deri tek ai i mesëm. Përveç kontrollit mjekësor, të aplikohet edhe kontrolli i nxënësve nga ana e psikologut, sidomos nga klasa e 8-të dhe 9-të me qëllim të ofrimit të ndihmës për tejkalimin e problemeve eventuale që rëndom mund të shfaqen si rezultat i moshës.


2 Problemi aktual që lidhet me çmimet e produkteve ushqimore që ofrohen brenda kampusit të shkollave të mesme dhe që janë më të larta se në tregun e lirë duhet të adresohet menjëherë nga ana e autoriteteve komunale. Problemi në fjalë ka dy aspekte: çmimet më të larta se në tregun jashtë kampusit paraqesin problem praktik për nxënësit që detyrohen të blejnë aty, dhe aspekti i dytë ka të bëjë me domosdoshmërinë e sqarimit të opinionit rreth procedurave dhe mënyrës së përzgjedhjes së kompanisë që operon brenda kampusit. Një sqarim i tillë do të mënjanonte edhe dilemat për keqpërdorime eventuale në proces.

3 Autoritetet komunale duhet të gjejnë mundësi për të siguruar transportin e fëmijëve nga niveli parafillor deri tek klasa e pestë (5) fillor, natyrisht në vendbanimet ku fëmijët duhet të udhëtojnë më larg për tek shkollat.

4 Është e domosdoshme që autoritetet komunale të kenë qasje të njëjtë për të gjitha shkollat në trajtimin e tyre. Autoritetet të gjejnë mundësi të pajisin të gjitha shkollat, pa dallim, me kabinete të nevojshme për punë praktike për lëndët gjegjëse, përfshirë edhe kabinetet me kompjuterë.

5 Autoritetet komunale me prioritet të vënë në funksion bibliotekën e qytetit. Po ashtu, kërkohet që furnizimi me literaturë të marrë në konsideratë drejtimet e ofruara nga fakultetet në Universitetet në komunë.

6 Autoritetet komunale të shikojnë mundësitë për ofrim të çmimeve të favorshme për nxënës dhe studentë, sidomos për ata që nuk kanë mundësi të mira ekonomike. Kategori të caktuara sociale të lirohen nga pagesa. Biblioteka të ofroj orar më të gjatë pune.





2

SEKTORI I RINISË



Problemet e identifikuara:

Roli dhe përgjegjësitë e autoriteteve lokale në krijimin e hapësirës për përfshirje të të rinjve në procesin e bërjes së politikave rinore është përcaktuar qartë me Ligjin për Fuqizimin e Rinisë dhe Strategjinë për të rinjtë 2013-2017. Për më tepër, Strategjia ka përcaktuar edhe objektivat strategjike që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe funksionalizimin e avancuar të sektorit të rinisë në nivelin lokal (Neni 3.1 i strategjisë).

Duke u bazuar në këto objektiva, grupi i të rinjve ka identifikuar çështjet në vijim si prioritete që kërkojnë adresim nga ana e autoriteteve lokale në Gjilan:

Është evidente mungesa e aktiviteteve për të rinjtë në të gjitha fushat dhe rritje e dukshme e apatisë tek të rinjtë. Ka mungesë vullneti për pjesëmarrje në aktivitete vullnetare në shërbim të komunitetit. Mungesë e aktiviteteve nga shtëpia e rinisë që do të krijonin hapësirë për përfshirje të të rinjve.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Është e domosdoshme që autoritetet komunale të promovojnë dhe ndihmojnë vullnetarizmin për të rinjtë. Komuna të nxjerr vendim ose rregullore për implementimin e Udhëzimit Administrativ për njohjen e punës vullnetare si pikënisje për nxitjen e aktivizmit tek të rinjtë.

2 Autoritetet duhet të nxisin të rinjtë për pjesëmarrje në aktivitete vullnetare përmes formave dhe mënyrave si p.sh.: lirim nga pagesa e biletës për kinema, mundësi për shfrytëzimin e teatrit pa pagesë nëse duan të shfaqin ndonjë film dokumentar për të rinjtë, pjesëmarrja në evenimente pa pagesë të organizuara nga komuna etj. Të rinjtë do të pajiseshin me kartela identifikuese dhe do të evidentoheshin në një databazë që do të mirëmbahej dhe përditësohej rregullisht qoftë nga stafi i shtëpisë së rinisë apo nga drejtoria komunale gjegjëse.

Komuna do të përfitoj duke llogaritur në përfshirjen e tyre në aksione me karakter vullnetar për të kryer shërbime për qytetarët. Të rinjtë do të ndjehen të vlerësuar dhe do të kultivojnë kulturën e përfshirjes në aktivitete publike në shërbim të komunitetit.

3 Shtëpia e rinisë duhet të funksionalizohet dhe autoritetet duhet domosdoshmërisht të depolitizojnë atë duke ua lënë menaxhimin e saj të rinjve. Shtëpia do të mund të pajisej me kompetencë për koordinimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të lartpërmendura dhe si hapësirë ku mblidhen të rinjtë e interesuar.





SEKTORI SOCIAL



Problemet e identifikuara:

Grupi i të rinjve ka trajtuar problemet me të cilat ballafaqohen kategoritë e qytetarëve me aftësi të kufizuara si çështje me prioritet dhe që kërkon vëmendje dhe trajtim adekuat nga ana e autoriteteve lokale. Këto kategori qytetarësh dhe në veçanti fëmijët nga këto kategori vazhdojnë të mbeten

larg integritit në shoqëri. Problemet e tyre kanë të bëjnë me mungesën e infrastrukturës elementare për qarkullim deri tek angazhimi i tyre në aktivitete sociale dhe kulturore.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:

1 Autoritetet komunale të identifikojnë të gjitha objektet shkollore në të cilat mungojnë pjerrinat e nevojshme për qarkullim të karrigeve lëvizëse dhe të njëjtat të i vendosin sa më parë. Veprimi i njëjtë të zbatohet edhe në të gjitha objektet tjera publike në qytet.

2 Autoritetet duhet të sigurojnë me prioritet librat me alfabetin e Brail-it.

3 Autoritetet komunale të gjejnë mundësi dhe të ndihmojnë edhe financiarisht funksionalizimin e organizatës PEMA që merret me këto kategori të qytetarëve.

4 Autoritetet komunale të sigurojnë transportin për fëmijët për këto kategori në shkolla, në veçanti në vendbanimet larg qytetit si dhe të siguroj shtigjet adekuate në pjesë kryesore dhe më të frekuentuara të qytetit. Fillimisht mund të trajtohen sheshet kryesore të qytetit dhe më pas, sipas mundësive, të zbatohet në të gjitha pjesët.





4

SEKTORI I AMBIENTIT



Problemet e identifikuara:

Grupi e të rinjve ka identifikuar çështjet që lidhen me gjendjen ambientale në komunë si problematikë që kërkon të adresohet dhe trajtohet me prioritet nga ana e autoriteteve lokale. Në këtë rrafsh, ata kanë identifikuar problemet prioritare si në vijim: Prania e deponive ilegale; Mungesa e ofrimit të shërbimeve cilësore për grumbullim të mbeturinave dhe problemin e vazhdueshëm me kompaninë

gjegjëse për menaxhim të mbeturinave; Mospërfshirja e zonave periferike dhe fshatrave në sistem të grumbullimit të mbeturinave. Problem që kërkon trajtim me prioritet është identifikuar edhe mungesa e një parku në qytet që do u shërbente qytetarëve për shëtitje dhe rekreacion.




Masat e propozuara – politika të nevojshme komunale për të adresuar këto probleme:


1 Autoritetet komunale duhet të largojnë me prioritet të gjitha deponitë ilegale.

2 Duhet të zgjidhet përfundimisht problemi me funksionimin e ndërmarrjes EKO Higjiena dhe e njëjta të ofroj shërbime cilësore për qytetarët. Të caktohen dhe mirëmbahen pika për grumbullim të mbeturinave. Të shtrihet rrjeti i ofrimit të shërbimeve të ndërmarrjes gjegjëse edhe në pjesët e pa përfshira si dhe nëpër fshatra. Së paku duhet të fillohet me pilotim të vendbanimeve më të mëdha për të vazhduar me tjerat më vonë. Komuna të ndihmoj me furnizim të kontejnerëve hapësirat ku pilotohet procesi i grumbullimit të mbeturinave.

3 Me qëllim të implementimit me sukses, kërkohen dy veprime shtesë nga ana e komunës: informim i gjerë për qytetarët për secilin veprim dhe aplikimin e masave ndëshkuese në rast të sjelljeve të papërgjegjshme të qytetarëve, si dhe, ngritjen e efikasitetit në punën e inspektorëve komunal, së paku për një periudhë fillestare, me qëllim të ndalimit të hedhjes së mbeturinave në vende të ndaluara.

4 Autoritetet komunale duhet të vendosin për ndërtim të një parku publik në periferi të qytetit për të krijuar hapësirë të nevojshme për qytetarët. Një projekt i tillë mund të ketë implikime më të mëdha buxhetore, por është e rëndësishme të trajtohet me prioritet dhe të fillohet.





Grupi i të rinjve që kanë kontribuar në hartimin e kësaj propozim-platforme:

AGNESA JASHARI

BLENDINA SAHITI

FATLUM AGUSHI

ALBRIM ISUFI

ENDERË SAHITI

FEKRI MEHMETI

ALFRED HALILI

ENSAR SHAQIRI

GENTIANA ISAKU

ALORA HYSENI

ERBLINA VESELI

GRESA SALIHU

AMBLA DEMI

ERIKA AGAJ

LOREN HYSENI

ARDONIS HALIMI

ERJONA HURUGLICA

NDERIM DEMIRI

ARLINDA HALIMI

ERUEND HAJRULLAHU


PARIS STARABAJA

BESJAN HAZIRI


FATLINDA DAKU

VLERË JANUZI





**Duke pasur parasysh kufizimet
buxhetore si dhe problemet që
ballafaqojnë komunat në procesin
e hartimit të buxheteve komunale,
diskutimi dhe puna e grupeve të të
rinjve është orientuar në identifikimin
e çështjeve që janë të prekshme,
të zbatueshme dhe që në pjesën
më të madhe nuk kanë implikime
të mëdha buxhetore.**



 KOSOVA
DEMOCRATIC
INSTITUTE



KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Projekti është mbështetur nga:



British Embassy
Pristina